



Nëqoftëse po e lexoni këtë në formatin të printuar dhe dëshironi të hyni në linket tona, thjesht na dërgoni e-mail në adresën spark.albania@gmail.com me titullin "Informacion për kampin Aventura" dhe ne do ju dërgojmë formatin elektronik.

Të dashur Pastorë/Drejtues

Jemi shumë të ngazëllyer që pas mungesë të detyruar vitin e kaluar për arsye të Covid-19, mund t'ju japim përsëri mundësinë për të qenë pjesë e Kampit Aventura këtë vit. Jemi të sigurtë që ju mund t'i vlerësoni dhe kuptoni përmasat e një iniciative të tillë, sidomos në kohë pandemie. Prandaj, do ta vlerësonim jashtë mase mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj ndërsa kërkojmë t'u shërbejmë fëmijëve tanë në mënyrë sa më efektive për Mbretërinë e Zotit tonë të gjallë.

Datat e kampit për këtë vit janë **16-21 Gusht** për moshën **9 – 14 vjeç** dhe kontributi është **3'500 Lekë** të reja.

Këtë vit kampi do të zhvillohet tek kompleksi 'Eden Park', Dajës, Tiranë. Ambjenti dhe kushtet janë shumë të mira për të zhvilluar një kamp plot me aventura. Në mes të natyrës është një ambient i përsosur, i sigurt dhe me kushte të shtuara pastërtie kundër Covid-19. Fëmijët do të kënaqen dhe do të rriten në njohjen e tyre për Perëndinë gjatë aktiviteteve të shumta të planifikuara veçanërisht për ata.

Shijoni një [video](#) të shkurtër nga kampi i fundit që kemi zhvilluar (2019).

40% e programit të organizuar prej nesh është drejtpërdrejtë shpirtëror duke pasur parasysh gjithashtu që edhe përmbajtja dhe atmosfera e kampit është për rritjen e nivelit shpirtëror të fëmijëve.

Disa pika që kemi dëshirë që ju t'i merrni në konsideratë:

Së pari, ju lutemi të merrni kohë që të lexoni me vëmendje njërin prej broshurave të kampit. Nëse do t'ju duhen më shumë kopje, ju lutemi të na e bëni të ditur sa ju duhen, në mënyrë që t'i sigurojmë për ju. Ose bashkangjitur keni linkun për [formularët e aplikimit 2021](#) që mund të printoni dhe fotokopjoni pjesën e aplikimit.

KUJDESTARËT

Për çdo 8 fëmijë që ju dërgoni në kamp duhet të dërgoni gjithashtu edhe një kujdestar. Kujdestari duhet të jetë mbi moshën 18 vjeç dhe do të kujdeset për fëmijët e moshës 9 – 14 vjeç. Kujdestari duhet të jetë i/e përgjegjshëm, të ketë një zemër shërbyese, të jetë i/e aftë për t'u kujdesur për fëmijët, i/e aftë për t'u komunikuar fëmijëve dashurinë e Perëndisë dhe të drejtojë një grup të vogël studimi materialin e të cilit do ta ketë të parapërgatitur. Nevojitet gjithashtu që marrin pjesë në një

trainim një ditë në mes dt. 03 -07 gusht, tek zyrat e Shkëndijës, Tiranë. Për këtë do t'ju dërgojmë më shumë informacion më vonë, pasi të kemi marrë të gjitha aplikimet. Bashkangjitur keni linkun për formularët e [aplikimit për kujdestarët](#). Kontributi për kujdestarët është njëlojë si për fëmijët në shumën prej 3'500 Lekë të reja. (Kostoja reale për një person në kamp është 11'500 Lekë)

KË MUND TË DËRGOJMË?

Fëmijë të krishterë të cilët ndjekin rregullisht programin tuaj të fëmijëve, të specifikuar sipas grupmoshave të kampit. (Ne jemi dakord që të vijnë edhe fëmijë jo të krishterë, të cilët ndjekin rregullisht programet tuaja, por me kusht që ata të mos jenë më shumë se 25 % të fëmijëve.)

SI TË REGJISTROHENI?

Hapi 1 – Bëni që prindërit e fëmijëve të plotësojnë dhe të firmosin formularët e regjistrimit si edhe t'ju japin juve bashkë me formularin edhe pagesën e plotë për fëmijët (që është vetëm 30 % e koston totale).

Hapi 2 – Ju mund të:

a) Sillni formularët e regjistrimit, të kontrolluar, së bashku me pagesat e plota direkt tek zyrat e "SHKËNDIJË", Rruga Fadil Rada nr 78, Tiranë. (Ju duhet të telefononi paraprakisht për të lenë një takim.)

ose

b) Nga formulari i plotësuar nga fëmijë/prindi, transferoni informacionin online përmes këtij linku: [formularët e aplikimit](#) online, dhe duke bërë derdhjen në llogarinë bankare me poshtë me përshkrimin -"Donacion për Kampin Aventura".

Bank Name:	First Investment Bank
Account Name:	Shkëndijë OJF
Account Number:	AL29 2151 1031 ALL1 0000 0724 1000
Bank IBAN:	AL29 2151 1031 ALL1 0000 0724 1000
Bank SWIFT Code:	FINVALTR

Kjo siguron rezervimin e fëmijëve por do të donim formularët me informacionin e plotë sa më shpejt.

Hapi 3 – Ne do t'ju konfirmojmë mbërritjen e formularëve/listën e emrave dhe të pagesës.

Vini re:

Data e fundit e regjistrimeve është data **15 Korrik 2021**.

Formularët e rregullt me pagesën e plotë në datën më të parë, do të jenë të parët të cilët do të kenë prioritet për vendet në kamp. Këtë vit janë vetëm **75 vende për fëmijët** në kamp. Prandaj, mos vononi!

Nëse në kohën kur regjistrohet fëmija juaj kampi është plot, ne do t'ju kontaktojmë. Nëse nuk do të ketë rrugëzgjidhje, atëherë pagesa e plotë do t'ju kthehet. Fëmijët të cilët nuk kanë mundësi të vijnë në kamp, mbas regjistrimit dhe pranimi nga ana jonë, ne do të kthejmë vetëm gjysmën e pagesës.

Për shkak të situatës të krijuar prej Covid-19, këtë vit rregullorja e pranimit të fëmijëve në kamp është përshtatur sipas kërkesave dhe kushteve higjienosanitare të kërkuara në kushte pandemie. Në momentin e nisjes, fëmijëve duhet tu matet temperatura përpara hipjes në autobusin që do të kryej transportin e tyre drejt mjediseve të kampit. Gjithashtu fëmijëve do tu matet temperatura edhe në momentin e mbërritjes në kamp. Ju lutemi tu bëhet e qartë prindërve që të mos dërgojnë fëmijët në kamp në rast se vetë fëmija ose ndonjë familjar i tij paraqet ndonjë simptomë të ngjashme me ato të Covid -19.

KOSTOJA REALE DHE KONTRIBUTET

Ju të cilët keni organizuar dhe zhvilluar një kamp rezidencial më përpara, jeni plotësisht të vetëdijshëm për sa i përket shpenzimeve që duhen. Çmimi që është vendosur për çdo fëmijë është vetëm një shumë e vogël e gjithë kostos reale. Pjesa tjetër e shpenzimeve për ushqimin dhe strehimin do të mbulohet me shumë mirësi nga sponsor të ndryshëm të Shkëndijës, por ka edhe shpenzime të tjera përveç atyre për të cilat po besojmë në Perëndinë për zgjidhje dhe do t'ju kërkonim të luteshit bashkë me ne.

Ju lutem, jini të ndërgjegjshëm ndaj të gjitha pikave të lartpërmendura në mënyrë që të na ndihmoni në kryerjen sa më efektive të kampit. Nëse keni ndonjë pyetje apo do të donit më shumë informacion ose nëse dëshironi të kontribuoni, ju lutemi që të mos hezitoni të na kontaktoni.

Në pritje të një Kampi fantastik këtë vit!

Në Krishtin, Zotin tonë

Rachel Wilson